

SHOQATA E PENSIONISTËVE E KOMUNËS SË SARAJIT

## CEREMONI ME RASTIN E JUBIELUT TË DHJETË



Shoqata e Pensionistëve të Komunës së Sarajit më 19.12.2017 në restorantin "Korabi" në Saraj ka shënuar përvjetorin e saj të dhjetë. Me këtë rast, në ceremoni morën pjesë kryetari i Komunës së Sarajit, Blerim Bexheti, delegacioni i LSHPM i udhëhequr nga nënkryetari i KE të LSHPM Salltir Karovski, kryetari i LSHP të Qytetit të Shkupit, Metodija Novkovski, si dhe përfaqësues nga SHP Tetovë, SHP Gostivar, SHP Kisella Vodë, SHPL, Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit, Fondacioni "Albiz" dhe shumë mysafirë të tjerë. Kryetari i Kuvendit të SHP Saraj, Baki Bakiu,

mes tjerash vuri në dukje pikat më kryesore nga puna e shoqatës në fushën e jetës kulturore-argëtuese, sportit, ruajtjes së shëndetit të pensionistëve, punës së klubit, bashkëpunimit të shoqatës me mediat e shtypit, opinionit në punë dhe të tjera, ndërsa promovoi edhe monografinë e shoqatës për aktivitetet dhjetëvjeçare.

Mahir Duraku, kryetari i KE, në fjalimin e tij ka folur për formimin e Shoqatës, nevojën për hapësirë dhe të tjera.

Kryetari i komunës së Sarajit,

Blerim Bexheti ka përshëndetur të pranishmit, u uroi për jubileun, si dhe për rezultatet e arritura gjatë viteve të kaluara dhe shprehu gatishtëri ndihmë të ndihmës së shoqatës në kufi të mundësive të komunës. Edhe nënkryetari i KE të LSHPM, Salltir Karovski përshëndeti të pranishmit, SHP Saraj i uroi jubileun dhe mes tjerash tha se kjo shoqatë është prezente në të gjitha aktivitetet e LSHPM.

Vadije Zendeli, kryetarja e Aktivitetit të pensionistëve të Gostivarit, krahas urimeve porositi se çdoherë pensionistët duhet të

gjejnë kohë për shoqërim dhe argëtim. Edhe kryetari i LSHP të Qytetit të Shkupit, Metodija Novkovski, u uroi jubileun. Pas përfundimit të urimeve, kryetari i KE të Shoqatës, Mahir Duraku u ndau mirënjohje për bashkëpunim: Komunës së Sarajit, LSHPM, LSHP të Qytetit të Shkupit, SHP Tetovë, SHP Gostivar, SHP Kisella Vodë, SHPL, Kryqi i Kuq të Qytetit të Shkupit, Fondacionit "Albiz", Zdravko Petkovskit dhe Rufat Ramadanit pas vdekjes. Në fund, manifestimi mbaroi me muzikë shqipe dhe maqedonase, pas çka të gjithë u kapën në valle.



## Ndihmë për më të rrezikuarit

Për 46 anëtarët e Shoqatës së Pensionistëve "Çair" është ndarë ndihmë financiare në shumë të përgjithshme prej 140.000 denarë. Siç informojnë nga kjo shoqatë, gjatë saktësisimit të ndihmës dhe përcaktimit të shfrytëzuesve, Komisioni për shëndetësi u përcaktua për pensionistët me pensione më të ulëta, ose të cilët në ndërkohë janë ballafaquar me fatkeqësi elementare dhe personat me dokumentacion mjekësor për sëmundje të rënda. Në bazë të propozimit, Këshilli ekzekutiv solli vendim për ndarjen e ndihmës së njëhershme të pakthyeshme financiare për këta persona në shumë prej 3000 denarë. Në dukje si shumë modeste, siç thonë, por megjithatë me këtë ngjallin shpresën e tyre se nuk janë lënë vetvetiu. Për pensionistët është me rëndësi ajo që u tregohet kujdes. "Çdo vit përpigemi së pari t'u ndihmojmë të sëmurëve, të dobëtëve dhe rasteve sociale. Shoqata jonë mban kujdes të pandërprerë për shëndetin dhe standardin e pensionistëve, që është edhe obligim i yni. Ndajmë mjete qëllimore për ndihmë të njëhershme financiare dhe konsideroj se ajo shkon në duart e duhura. Në programin e Shoqatës kemi paraparë edhe aktivitetet e tjera, mes të cilave edhe vizitë të të sëmurëve dhe personave të plogësht, që e bëjmë së bashku me degët dhe Aktivin e pensionistëve", deklaroi Mentor Qoku, kryetari i Shoqatës.

## Rezultate edhe më të mira

Aktivi i pensionistëve të Shoqatës së Pensionistëve të Dibrës dhe Qendër Zhupë më 29 dhjetor 2017 ka organizuar pritjen e Vitit të Ri 2018 në hotelin "Leon". Në një atmosferë të këndshme me këngë e muzikë janë shoqëruar 40 pensioniste nga të gjitha nacionalitetet. Në këtë takim me bashkëpunëtorët e përafërt morën pjesë kryetari i Shoqatës, Xhavit Karpuzi dhe kryetari i Komisionit për kulturë-jetë argëtuese. Gjatë hapjes së manifestimit dhe urimit të Vitit të Ri, kryetari Xhavit Karpuzi ka arsy-



tuar sukseset e Shoqatës në vitin 2017 dhe shprehu shpresën për rezultate edhe më të mira gjatë

vitit të ardhshëm. Ai falënderim të posaçëm shprehu për Aktivin e pensionistëve për iniciimin dhe

ndihmën në organizimin e takimit. Edhe kryetarja e Aktivitetit të pensionistëve, Marijonka Ushtelena, të pranishmëve u uroi Vitin e Ri 2018 dhe u dëshiroi plotësimin e dëshirave për jetë të shëndetshme dhe të gjatë. Ajo theksoi se ky Aktiv vit për vit po bëhet me numër më të madh dhe merr pjesë në të gjitha aktivitetet në nivel lokal, rajonal dhe republikan. Shoqërimi ishte shumë orësh, deri në mbrëmje dhe të gjithë i uruan njëri-tjetrit shëndet të mirë, fat dhe gëzime me familjet.

SHOQATA E PENSIONISTËVE TË KUMANOVËS

## ARGËTIM SPORTIV PËR VITIN E RI

Mbrëmjen tradicionale argëtuese-sportive të Vitit të Ri, Shoqata e Pensionistëve të Kumanovës e mbajti më 28.12.2017 në restorantin "Gracia" në prezencë të rreth 350 pensionistëve, mes të cilëve edhe nga degët e fshatrave Pçinja, Agino Sello dhe Umin Doll. Të pranishmit i përshëndeti dhe u uroi festat e fundvitit kryetari i SHP Spirko Nikollovski. Në emër të vetëqeverisjes lokale foli udhëhe-

qësi i Komisionit për kulturë dhe sport Coki Ristovski, ndërsa një kthesë të shkurtë për programin e realizuar në vitin 2017 dha kryetari i Komisionit për sport Lube Dimitrievski. Pastaj u shpallën sportistët më të suksesshëm pensionistë të cilët në GSRP e 22-ta kanë fituar medalje. Për sportist të vitit u shpall Mirjana Andonoviç, e cila fitoi medaljen e artë në hedhjen e gjyles, ndërsa ishte e propozuar për

sportiste më të suksesshme pensioniste që e shpallë Lidhja komunale e sporteve në nivel të qytetit. Për ekip më të suksesshëm, fitues të medaljes së artë në gjuajtjen e panaltive në gola të vegjël janë shpallur: Lubinka Denkovska, Milenka Krstevska, Margarita Bozhinovska dhe Sllavica Milenkovska. Garuesve më të mirë iu bashkangjiten edhe sportistët me medalje të argjendtë Jasmina To-



dorovska dhe Blazho Stanojkov. Trajneri më i suksesshëm në disiplinat e atletikës u shpall Mirko Cvetkovski, ndërsa punëtori më i suksesshëm sportiv Jovica Vançevski, i cili ishte edhe refer republikan në domino. Si garuesi më i moshuar në shah është veçuar pen-

sionistja Vera Zoriq. Sportistëve të përmendur u janë ndarë diploma dhe dhurata modeste. Mbrëmja ishte argëtuese, pensionistët ishin tejet të kënaqur dhe nuk u ndalën duke kënduar dhe vallëzuar. Takimi i madhërua me një fotografi të përbashkët.